FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 97

Tiranë – E hënë, 2 korrik 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 33/2018 datë 7.6.2018	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos "Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për disenjot industriale".....	6111
Ligj nr. 34/2018 datë 7.6.2018	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës "Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare".....	6116
Ligj nr. 35/2018 datë 21.6.2018	Për pagesën e detyrimeve të prapambetura në favor të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).....	6123
Ligj nr. 36/2018 datë 21.6.2018	Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995, "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995, "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)" dhe dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995, "Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995, "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit"", të ndryshuar".....	6124
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 20.6.2018	Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale.....	6124
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 370 , datë 20.6.2018	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 11.6.2009; nr. 1039, datë 14.10.2009; nr. 901, datë 12.12.2012; nr. 449, datë 27.5.2015; nr. 801, datë 30.9.2015; nr. 563, datë 29.7.2016; nr. 849, datë 7.12.2016; nr. 230, datë 21.3.2017; nr. 367, datë 26.4.2017, për shpërblimin e pronarëve, për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale.....	6153

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 20.6.2018	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1481, datë 12.11.2008; nr. 1657, datë 24.12.2008; nr. 100, datë 27.1.2009; nr. 167, datë 19.2.2009; nr. 286, datë 18.3.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 1134, datë 18.11.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 404, datë 26.5.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 359, datë 4.5.2011; nr. 822, datë 23.11.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 472, datë 30.5.2013; nr. 686, datë 16.8.2013; nr. 823, datë 7.10.2015; nr. 446, datë 15.6.2016, për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale, të ndryshuara.....	6158
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 380, datë 20.6.2018	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për ndërtimin e një fabrike për prodhimin, ambalazhimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm nga shoqëria "Puka uji natyral" sh.p.k.....	6167

LIGJ
Nr. 33/2018

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E LOKARNOS "PËR PËRCAKTIMIN E NJË KLASIFIKIMI NDËRKOMBËTAR PËR DISENJOT INDUSTRIALE"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen e Lokarnos "Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për disenjot industriale", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.6.2018

Shpallur me dekretin nr. 10814, datë 25.6.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJA E LOKARNOS
PËR PËRCAKTIMIN E NJË KLASIFIKIMI NDËRKOMBËTAR PËR DIZENJOT INDUSTRIALE
E nënshkruar në Lokarno, më 8 tetor 1968
dhe e ndryshuar më 28 shtator 1979

Neni 1
Themelimi i një Unioni të Posaçëm; miratimi i një Klasifikimi Ndërkombëtar

1. Vendet ku zbatohet kjo Marrëveshje përbëjnë një Union të Posaçëm.

2. Këto vende miratojnë një klasifikim të vetëm për dizenjot industriale (në vijim i referuar si "Klasifikimi Ndërkombëtar").

3. Klasifikimi Ndërkombëtar përbëhet nga:

i. një listë e klasave dhe e nënklasave;

ii. një listë alfabetike e mallrave ku përfshihen dizenjot industriale, me një tregues të klasave dhe nënklasave ku ato kategorizohen;

iii. shënime shpjeguese.

4. Lista e klasave dhe e nënklasave është lista bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje, objekt i këtyre ndryshimeve dhe shtesave, siç përcaktohet nga Komiteti i Ekspertëve, sipas nenit 3 (në vijim i referuar si "Komiteti i Ekspertëve").

5. Lista alfabetike e mallrave dhe e shënimeve shpjeguese miratohet nga Komiteti i Ekspertëve, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 3.

6. Klasifikimi Ndërkombëtar mund të ndryshohet ose plotësohet nga Komiteti i Ekspertëve, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 3.

7. a)Klasifikimi Ndërkombëtar hartohet në gjuhët angleze dhe frënge.

b) Tekstet zyrtare të Klasifikimit Ndërkombëtar, në gjuhë të tjera, siç mund të përcaktohen nga Asambleja e përmendur në nenin 5, përcaktohen pas konsultimit me qeveritë e interesuara, nga Byroja Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale (në vijim e referuar si "Byroja Ndërkombëtare"), e përmendur në Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (në vijim e referuar si "Organizata").

Neni 2
Përdorimi dhe fusha ligjore e veprimit të Klasifikimit Ndërkombëtar

1. Sipas kërkesave të përshkruara në këtë Marrëveshje, Klasifikimi Ndërkombëtar ka vetëm karakter administrativ. Megjithatë, secili vend mund të vendosë atë fushë ligjore veprimi që e çmon të përshtatshme. Në veçanti, Klasifikimi Ndërkombëtar nuk i detyron vendet e Unionit të Posaçëm në lidhje me natyrën dhe objektin e mbrojtjes që u jepet dizenjove në ato vende.

2. Secili vend i Unionit të Posaçëm rezervon të drejtën për të përdorur Klasifikimin Ndërkombëtar si një sistem parësor ose sistem ndihmës.

3. Zyrat e vendeve të Unionit të Posaçëm duhet të përfshijnë në dokumentet zyrtare për depozitimin ose për regjistrimin e dizenjove dhe, nëse janë botuar zyrtarisht, në botimet në fjalë, numrat e klasave dhe të nënklasave të Klasifikimit Ndërkombëtar ku kategorizohen mallrat që i përkasin dizenjos.

4. Në përzgjedhjen e kushteve për përfshirjen në listën alfabetike të mallrave, Komiteti i Ekspertëve tregon kujdes të arsyeshëm për shmangien e përdorimit të kushteve ku mund të ekzistojnë të drejtat ekskluzive. Megjithatë, përfshirja e ndonjë fjale në indeksin alfabetik nuk përbën shprehje të opinionit të Komitetit të Ekspertëve në lidhje me faktin nëse është objekt i të drejtave ekskluzive apo jo.

Neni 3
Komiteti i Ekspertëve

1. Komitetit të Ekspertëve i besohen detyrat e përmendura në nenin 1, paragrafët 4 dhe 5 dhe në nenin 1, paragrafi 6. Çdo vend i Unionit të Posaçëm përfaqësohet në Komitetin e Ekspertëve, i cili organizohet sipas rregullave të procedurës të miratuara me shumicë të thjeshtë të vendeve të përfaqësuara.

2. Komiteti i Ekspertëve miraton listën alfabetike dhe shënimet shpjeguese me shumicë të thjeshtë të votave të vendeve të Unionit të Posaçëm.

3. Propozimet për ndryshime ose shtesa në Klasifikimin Ndërkombëtar mund të kryhen nga zyra e çdo vendi të Unionit të Posaçëm ose nga Byroja Ndërkombëtare. Çdo propozim që paraqitet nga një zyrë përcillet nga ajo zyrë pranë Byrosë Ndërkombëtare. Propozimet nga zyrat dhe Byroja Ndërkombëtare përcillen nga këto të fundit tek anëtarët e Komitetit të Ekspertëve jo më vonë se dy muaj para seancës së Komitetit ku do të shqyrtohen propozimet e lartpërmendura.

4. Vendimet e Komitetit të Ekspertëve, në lidhje me miratimin e ndryshimeve dhe të shtesave të Klasifikimin Ndërkombëtar, do të merren me shumicë të thjeshtë votash të vendeve të Unionit të Posaçëm. Megjithatë, nëse këto vendime sjellin krijimin e një klase të re ose transferim të mallrave nga njëra klasë në tjetrën, kërkohet unanimitet.

5. Çdo ekspert ka të drejtë të votojë me postë.

6. Nëse një vend nuk emëron një përfaqësues për një seancë të caktuar të Komitetit të Ekspertëve, ose nëse eksperti i emëruar nuk e ka hedhur votën e tij gjatë seancës ose brenda një afati të caktuar nga rregullat e procedurës së Komitetit të Ekspertëve, vendi në fjalë konsiderohet se e ka pranuar vendimin e Komitetit.

Neni 4
Njoftimi dhe botimi i klasifikimit dhe i ndryshimeve dhe shtesave të tyre

1. Lista alfabetike e mallrave dhe shënimet shpjeguese të miratuara nga Komiteti i Ekspertëve, si dhe çdo ndryshim ose shtim i Klasifikimit Ndërkombëtar të vendosur nga Komiteti, u përcillet zyrave të vendeve të Unionit të Posaçëm nga Byroja Ndërkombëtare. Vendimet e Komitetit të Ekspertëve hyjnë në fuqi sapo ky komunikim të jetë pranuar. Megjithatë, nëse këto vendime sjellin krijimin e një klase të re ose transferimin e mallrave nga njëra klasë në tjetrën, ato hyjnë në fuqi brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data e komunikimit në fjalë.

2. Byroja Ndërkombëtare, si depozitare e Klasifikimit Ndërkombëtar, përfshin ndryshimet dhe shtesat që kanë hyrë në fuqi. Njoftimet e ndryshimeve dhe shtesave publikohen në botimin periodik që caktohet nga Asambleja.

Neni 5
Asambleja e Unionit të Posaçëm

1. a) Unioni i Posaçëm ka një Asamble të përbërë nga vendet e Unionit të Posaçëm.

b) Qeveria e secilit vend të Unionit të Posaçëm përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë, këshilltarë dhe ekspertë të ndryshëm.

c) Shpenzimet e secilit delegacion mbulohen nga qeveria që e ka caktuar atë.

2. a) Në bazë të dispozitave të nenit 3, Asambleja:

i. trajton të gjitha çështjet që lidhen me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit të Posaçëm dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

ii. jep udhëzime për Byronë Ndërkombëtare në lidhje me përgatitjen për konferencat e rishikimit;

iii. shqyrton dhe miraton raportet dhe veprimtaritë e Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës (në vijim i referuar si "Drejtori i Përgjithshëm") në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe i jep atij të gjitha udhëzimet e nevojshme për çështjet që mbulohen nga Unioni i Posaçëm;

iv. përcakton programin dhe miraton buxhetin dyvjeçar të Unionit të Posaçëm dhe miraton llogaritë e tij përfundimtare;

v. miraton rregulloret financiare të Unionit të Posaçëm;

vi. vendos për hartimin e teksteve zyrtare të Klasifikimit Ndërkombëtar në gjuhë të ndryshme, përveç gjuhës angleze dhe frënge;

vii. themelon, përveç Komitetit të Ekspertëve, të krijuar sipas nenit 3, komitete të tjera ekspertësh dhe grupe pune që i çmon të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të Unionit të Posaçëm;

viii. përcakton cilat vende nuk janë anëtare të Unionit të Posaçëm dhe cilat organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare do të pranohen në takimet e tyre në rolin e vëzhguesit;

ix. miraton ndryshime në nenet 5 deri 8;

x. ndërmerr çdo masë tjetër të përshtatshme që synon të zhvillojë më tej objektivat e Unionit të Posaçëm;

xi. kryen funksione të tjera të përshtatshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në lidhje me çështjet me interes edhe për sindikatat e tjera nën administrimin e Organizatës, Asambleja merr vendimet e saj, pasi të ketë dëgjuar këshillën e Komitetit Koordinues të Organizatës.

3. a) Çdo anëtar i vendit të Asamblesë gëzon një votë.

b) Gjysma e vendeve anëtare të Asamblesë përbën një kuorum.

c) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit "b", nëse në ndonjë seancë numri i vendeve të përfaqësuara është më pak se gjysma, por i barabartë ose më i madh se një e treta e vendeve anëtare të Asamblesë, Asambleja mund të marrë vendime, por, me përjashtim të vendimeve që lidhen me procedurën e vet, të gjitha vendimet e tjera hyjnë në fuqi vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara më poshtë. Byroja Ndërkombëtare ua komunikon vendimet në fjalë vendeve anëtare të Asamblesë që nuk janë të përfaqësuara dhe i fton të hedhin me shkrim votën e tyre ose të abstenojnë brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Nëse, pas skadimit të kësaj periudhe, numri i vendeve që kanë hedhur votën ose kanë abstenuar në këtë mënyrë arrin numrin e shteteve që mungonin për arritjen e kuorumit në seancë, këto vendime hyjnë në fuqi me kusht që në të njëjtën kohë të arrihet shumica e nevojshme.

d) Në bazë të dispozitave të nenit 8, paragrafi 2, vendimet e Asamblesë kërkojnë dy të tretat e votave të hedhura.

e) Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

f) Një delegat mund të përfaqësojë dhe të votojë vetëm në emër të një vendi.

4. a) Asambleja mblidhet një herë çdo vit të dytë kalendarik në seancë të zakonshme pas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm dhe, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë së njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend si Asambleja e Përgjithshme e Organizatës.

b) Asambleja mblidhet në seancë të jashtëzakonshme pas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm, me kërkesën e një të katërtës së vendeve anëtare të Asamblesë.

c) Rendi i ditës i çdo seance përgatitet nga Drejtori i Përgjithshëm.

5. Asambleja miraton vetë rregulloren e saj të brendshme.

Neni 6
Byroja Ndërkombëtare

1. a) Detyrimet administrative në lidhje me Unionin e Posaçëm përmbushen nga Byroja Ndërkombëtare.

b) Në veçanti, Byroja Ndërkombëtare përgatit mbledhjet dhe siguron Sekretariatin e Asamblesë, Komitetin e Ekspertëve dhe komitetet e tjera të ekspertëve dhe grupet e punës, siç janë krijuar nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve.

c) Drejtori i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i Unionit të Posaçëm dhe përfaqëson Unionin e Posaçëm.

2. Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar tjetër i stafit të caktuar prej tij merr pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Asamblesë, të Komitetit të Ekspertëve dhe të komiteteve të tjera të ekspertëve ose të grupeve të punës që mund të jenë krijuar nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve. Drejtori i Përgjithshëm ose një anëtar tjetër i stafit të caktuar prej tij është sekretar *ex officio*/i caktuar kryesisht i këtyre organeve.

3. a) Byroja Ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e Asamblesë, kryen përgatitjet për konferencat e rishikimit të dispozitave të Marrëveshjes, përveç dispozitave të neneve 5 deri në 8.

b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare në lidhje me përgatitjet për konferencat e rishikimit.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e zhvilluara në këto konferenca.

4. Byroja Ndërkombëtare kryen çdo detyrë tjetër që i është caktuar.

Neni 7
Financat

1. a) Unioni i Posaçëm ka një buxhet.

b) Buxheti i Unionit të Posaçëm përfshin të ardhurat dhe shpenzimet që i takojnë Unionit të Posaçëm, kontributin e tij në buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta për sindikatat dhe sipas rastit, shumën e vënë në dispozicion të buxhetit të konferencës së Organizatës.

c) Shpenzimet që nuk i atribuohen ekskluzivisht Unionit të Posaçëm, por as ndonjë apo më shumë sindikatave të tjera të administruara nga Organizata, konsiderohen si shpenzime të përbashkëta për sindikatat. Pjesa e këtyre shpenzimeve të përbashkëta që i takon Unionit të Posaçëm është në raport me interesin e Unionit të Posaçëm në to.

2. Buxheti i Unionit të Posaçëm krijohet duke pasur parasysh kërkesat e koordinimit me buxhetet e sindikatave të tjera të administruara nga Organizata.

3. Buxheti i Unionit të Posaçëm financohet nga burimet e mëposhtme:

i. kontributet e vendeve të Unionit të Posaçëm;

ii. tarifat dhe detyrimet për shërbime të kryera nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm;

iii. shitjen e/ose honorarët nga botimet e Byrosë Ndërkombëtare, në lidhje me Unionin e Posaçëm;

iv. dhuratat, trashëgimia dhe subvencionet;

v. qiratë, interesat dhe të ardhura të tjera të ndryshme.

4. a)Për qëllimin e përcaktimit të kontributit të përmendur në paragrafin 3, germa "i", secili vend i Unionit të Posaçëm i përket së njëjtës klasë që i përket në Unionin e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe paguan kontributet e tij vjetore në bazë të njësive të përcaktuara për atë klasë në atë Union.

b) Kontributi vjetor i secilit vend të Unionit të Posaçëm është shuma në raport me shumën totale që duhet të paguhet në buxhetin e Unionit të Posaçëm nga të gjitha vendet, sipas numrit të njësive në totalin e njësive të të gjitha vendeve kontribuese.

c) Kontributet duhet të paguhen në fillim të muajit janar të çdo viti.

d) Vendi që nuk paguan kontributin e tij nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij të votës në asnjë organ të Unionit të Posaçëm, nëse shuma e detyrimit të tij është e barabartë ose më e madhe se shuma e kontributeve që i detyrohen atij për dy vitet e plota të mëparshme. Megjithatë, çdo organ i Unionit të Posaçëm mund të lejojë që ky vend të vazhdojë të ushtrojë të drejtën e tij të votës në atë organ, nëse dhe për sa kohë që bindet se vonesa e pagesës ka ndodhur për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të pashmangshme.

e) Nëse buxheti nuk miratohet para fillimit të një periudhe të re financiare, ai duhet të jetë në të njëjtin nivel me buxhetin e vitit paraprak, siç parashikohet në rregulloret financiare.

5. Duhet të vendoset shuma e tarifave dhe e detyrimeve për shërbimet e kryera nga Byroja Ndërkombëtare, në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i raportojë Asamblesë këtë shumë.

6. a)Unioni i Posaçëm ka një fond të kapitalit qarkullues, i cili përbëhet nga një pagesë e vetme e kryer nga çdo vend i Unionit të Posaçëm. Nëse ky fond bëhet i pamjaftueshëm, Asambleja vendos ta rrisë atë.

b) Shuma e pagesës fillestare të secilit vend në fondin në fjalë ose pjesëmarrja e tij në rritjen e këtij fondi është pjesë e kontributit të atij vendi për vitin kur është krijuar ky fond ose kur është marrë vendimi për rritjen e tij.

c) Pjesa dhe kushtet e pagesës përcaktohen nga Asambleja me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe pasi të ketë dëgjuar këshillat e Komitetit Koordinues të Organizatës.

7. a)Në Marrëveshjen për selinë, të nënshkruar me vendin në territorin e të cilit Organizata ka selinë, duhet të parashikohet që sa herë që fondi i kapitalit qarkullues të jetë i pamjaftueshëm, ky vend duhet të paguajë pagesa paraprake. Shuma e këtyre pagesave paraprake dhe kushtet e pagesës u nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta, në çdo rast, ndërmjet këtij vendi dhe Organizatës.

b) Vendi i përmendur në nënparagrafin "a" dhe Organizata kanë të drejtë të përfundojnë detyrimin për dhënien e pagesave paraprake, nëpërmjet një njoftimi me shkrim. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi tre vjet pas përfundimit të vitit kur është njoftuar.

8. Auditimi i llogarive kryhet nga një ose më shumë vende të Unionit të Posaçëm ose nga audituesë të jashtëm, siç parashikohet në

rregulloret financiare. Ato përcaktohen nga Asambleja me miratimin e tyre.

Neni 8
Ndryshimi i neneve 5 deri në 8

1. Propozimet për ndryshimin e neneve 5, 6, 7 dhe të këtij neni mund të iniciohen nga çdo vend i Unionit të Posaçëm ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm u komunikon këto propozime vendeve të Unionit të Posaçëm, të paktën gjashtë muaj para shqyrtimit të tyre nga Asambleja.

2. Ndryshimet në nenet e përmendura në paragrafin 1 miratohen nga Asambleja. Ky miratim kërkon tri të katërtat e votave të hedhura, me kusht që çdo ndryshim i nenit 5 dhe i këtij paragrafi të kërkojë katër të pestat e votave të hedhura.

3. Çdo ndryshim i neneve të përmendura në paragrafin 1 hyn në fuqi një muaj pasi njoftimet me shkrim të pranimit, të miratuara në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese, të jenë pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm nga tri të katërtat e vendeve anëtare të Unionit të Posaçëm në momentin e miratimit të këtij ndryshimi. Çdo ndryshim i këtyre neneve të pranuara në këtë mënyrë i detyron të gjitha vendet anëtare të Unionit të Posaçëm në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimit ose vendet që anëtarësohen pas kësaj date, me kusht që çdo ndryshim që rrit detyrimet financiare të vendeve të Unionit të Posaçëm të jetë detyrues vetëm për ato vende që kanë njoftuar pranimin e këtyre ndryshimeve.

Neni 9
Ratifikimi dhe aderimi; hyrja në fuqi

1. Çdo shtet palë në Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale që ka nënshkruar këtë Marrëveshje mund ta ratifikojë atë dhe, nëse nuk e ka nënshkruar këtë Marrëveshje, mund të aderojë në të.

2. Instrumentet e ratifikimit dhe të aderimit depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

3. a) Në lidhje me pesë vendet e para që kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit, kjo Marrëveshje hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të pestë.

b) Për sa i përket çdo vendi tjetër, kjo Marrëveshje hyn në fuqi tre muaj pas datës kur Drejtori i Përgjithshëm njofton për ratifikimin ose aderimin e saj, përveç nëse në instrumentin e ratifikimit ose të aderimit shënohet ndonjë datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, kjo Marrëveshje hyn në fuqi vetëm për atë vend në datën e shënuar për këtë qëllim.

4. Ratifikimi ose aderimi sjell automatikisht pranimin e të gjitha klauzolave dhe pranimin e të gjitha përparësive të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10
Zbatimi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje ka të njëjtën fuqi dhe kohëzgjatje si Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

Neni 11
Rishikimi i neneve 1 deri 4 dhe 9 deri 15

1. Nenet 1 deri 4 dhe 9 deri 15 të kësaj Marrëveshjeje mund të dërgohen për rishikim, me synim paraqitjen e përmirësimeve të dëshiruara.

2. Çdo rishikim do të shqyrtohet në një konferencë që do të zhvillohet ndërmjet delegatëve të vendeve të Unionit të Posaçëm.

Neni 12
Prishja e Marrëveshjes

1. Çdo vend mund ta prishë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm. Prishja e kësaj Marrëveshjeje cenon vetëm vendin që prish Marrëveshjen, dhe Marrëveshja mbetet në fuqi dhe me efekt të plotë për vendet e tjera të Unionit të Posaçëm.

2. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi një vit pas datës kur Drejtori i Përgjithshëm merr njoftimin.

3. E drejta e prishjes së Marrëveshjes e parashikuar në këtë nen nuk ushtrohet nga asnjë vend para përfundimit të afatit pesëvjeçar nga data kur ky vend bëhet anëtar i Unionit të Posaçëm.

Neni 13
Territoret

Dispozitat e nenit 24 të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale zbatohen për këtë Marrëveshje.

Neni 14
Nënshkrimi, gjuha, njoftimet

1. a) Kjo Marrëveshje nënshkruhet në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe frënge, ku tekstet në të dyja gjuhët janë njëlloj autentike dhe depozitohen në qeverinë e Zvicrës.

b) Kjo Marrëveshje mbetet e hapur për nënshkrim në Bernë, deri më 30 qershor 1969.

2. Tekstet zyrtare përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara, në gjuhë të tjera, siç përcaktohen nga Asambleja.

3. Drejtori i Përgjithshëm përcjell dy kopje të tekstit të nënshkruar të kësaj Marrëveshjeje, të certifikuara nga qeveria e Zvicrës, qeverive të vendeve që e kanë nënshkruar atë dhe, me kërkesë të tyre, qeverisë së çdo vendi tjetër.

4. Drejtori i Përgjithshëm e regjistron këtë Marrëveshje në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara.

5. Drejtori i Përgjithshëm njofton qeveritë e të gjitha vendeve të Unionit të Posaçëm për datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, nënshkrimit, depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të aderimit, pranimet e ndryshimeve të kësaj Marrëveshjeje dhe datat e hyrjes në fuqi të këtyre marrëveshjeve, dhe njoftimet e prishjes së marrëveshjeve.

Neni 15
Dispozita kalimtare

Derisa Drejtori i parë Përgjithshëm të marrë detyrën, referencat në këtë Marrëveshje për Byronë Ndërkombëtare të Organizatës ose për Drejtorin e Përgjithshëm konsiderohen përkatësisht si referenca për Byrotë e Bashkuara Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (BIRPI) ose për drejtorin e kësaj zyre.

LIGJ
Nr. 34/2018

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E VJENËS "PËR KLASIFIKIMIN NDËRKOMBËTAR TË ELEMENTEVE FIGURATIVE TË MARKAVE TREGTARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen e Vjenës "Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.6.2018

Shpallur me dekretin nr. 10815, datë 25.6.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJA E VJENËS
PËR KLASIFIKIMIN NDËRKOMBËTAR TË ELEMENTEVE FIGURATIVE TË MARKAVE TREGTARE

E nënshkruar në Vjenë, më 12 qershor 1973,
e ndryshuar më 1 tetor 1985

TABELË E LËNDËS*

Neni 1. Themelimi i një Unioni të Posaçëm; miratimi i një Klasifikimi Ndërkombëtar
Neni 2. Përkufizimi dhe depozitimi i Klasifikimit të Elementeve Figurative
Neni 3. Gjuhët e Klasifikimit të Elementeve Figurative
Neni 4. Përdorimi i Klasifikimit të Elementeve Figurative
Neni 5. Komiteti i Ekspertëve
Neni 6. Njoftimi, hyrja në fuqi dhe botimi i ndryshimeve, shtesave dhe vendimeve të tjera
Neni 7. Asambleja e Unionit të Posaçëm
Neni 8. Byroja Ndërkombëtare
Neni 9. Financat
Neni 10. Rishikimi i Marrëveshjes
Neni 11. Ndryshime të disa dispozitave të caktuara të Marrëveshjes
Neni 12. Të bërit palë në këtë Marrëveshje

* Kjo tabelë e lëndës shtohet për lehtësinë e lexuesit. Ajo nuk përfshihet në tekstin e nënshkruar të Marrëveshjes.

Neni 13. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes
Neni 14. Kohëzgjatja e Marrëveshjes
Neni 15. Prishja e Marrëveshjes
Neni 16. Mosmarrëveshjet
Neni 17. Nënshkrimi, gjuhët, funksionet e depozitarit, njoftimet

Palët Kontraktuese,

duke pasur parasysh nenin 19 të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale të 20 marsit 1883, të rishikuar në Bruksel më 14 dhjetor 1900, në Uashington më 2 qershor 1911, në Hagë më 6 nëntor 1925, në Londër më 2 qershor 1934, në Lisbonë më 31 tetor 1958 dhe në Stokholm më 14 korrik 1967,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Themelimi i Unionit të Posaçëm; miratimi i Klasifikimit Ndërkombëtar

Vendet ku zbatohet kjo Marrëveshje formojnë Unionin e Posaçëm dhe miratojnë klasifikimin e përbashkët për elementet figurative të markave (në vijim i referuar si "Klasifikimi i Elementeve Figurative").

Neni 2
Përkufizimi dhe depozitimi i Klasifikimit të Elementeve Figurative

1. Klasifikimi i Elementeve Figurative përbëhet nga lista e kategorive, ndarjeve dhe seksioneve ku klasifikohen elementet figurative të markave, bashkë me shpjegimet përkatëse, sipas rastit.

2. Klasifikimi i Elementeve Figurative është përpiluar në një dokument origjinal, në gjuhën angleze dhe frënge, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore për Pronësinë Industriale (në vijim i referuar si "Drejtori i Përgjithshëm" dhe "Organizata"), në momentin kur kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim.

3. Ndryshimet dhe shtesat e përmendura në nenin 5, paragrafi 3, germa "i" përpilohen, gjithashtu, në një dokument origjinal në gjuhën angleze dhe frënge, të nënshkruar nga/dhe të depozituara te Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 3
Gjuhët e Klasifikimit të Elementeve Figurative

1. Klasifikimi i Elementeve Figurative është përpiluar në gjuhën angleze dhe franceze, ku të dyja tekstet janë njëlloj origjinale.

2. Byroja Ndërkombëtare e Organizatës (në vijim e referuar si "Byroja Ndërkombëtare"), në konsultim me qeveritë e interesuara, përpilon një tekst zyrtar të Klasifikimit të Elementeve Figurative, në gjuhët e caktuara nga Asambleja, sipas nenit 7, në përputhje me paragrafin 2, germa "a", pika "vi" të atij neni.

Neni 4
Përdorimi i Klasifikimit të Elementeve Figurative

1. Në bazë të kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, objekti i Klasifikimit të Elementeve Figurative është ai që jepet nga çdo vend i Unionit të Posaçëm. Në veçanti, Klasifikimi i elementeve figurative nuk i detyron vendet e Unionit të Posaçëm në lidhje me shkallën e mbrojtjes që i jepet kësaj marke.

2. Zyrat kompetente në vendet e Unionit të Posaçëm kanë të drejtë ta përdorin Klasifikimin e Elementeve Figurative si sistem kryesor ose si sistem ndihmës.

3. Zyrat kompetente të vendeve të Unionit të Posaçëm, në dokumentet dhe botimet zyrtare që lidhen me regjistrimin e markave dhe me rinovimin e tyre, duhet të përfshijnë numrat e kategorive, ndarjeve dhe seksioneve ku vendosen elementet figurative të asaj marke.

4. Para këtyre numrave duhet të vendosen fjalët "Klasifikimi i Elementeve Figurative" ose shkurtimi i tyre, i cili përcaktohet nga Komiteti i Ekspertëve, i përmendur në nenin 5.

5. Çdo vend, në momentin e nënshkrimit apo të depozitimit të instrumentit për ratifikim ose për aderim, mund të deklarojë se nuk merr përsipër t'i përfshijë numrat e të gjitha apo të disa seksioneve në dokumentet zyrtare dhe botimet që lidhen me depozitimin e markave dhe rinovimin e tyre.

6. Nëse ndonjë vend i Unionit të Posaçëm ia beson regjistrimin e markave ndonjë autoriteti ndërqeveritar, ai ndërmerr të gjitha masat për të garantuar që ky autoritet të shfrytëzojë

Klasifikimin e Elementeve Figurative në përputhje me këtë nen.

Neni 5
Komiteti i Ekspertëve

1. Duhet të krijohet një Komitet i Ekspertëve ku do të përfaqësohet çdo vend i Unionit të Posaçëm.

2.

a) Drejtori i Përgjithshëm mund dhe, nëse kërkohet nga Komiteti i Ekspertëve, duhet të ftojë edhe vendet që nuk janë anëtare të Unionit të Posaçëm, të cilat janë anëtarë të Organizatës ose Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, që të marrin pjesë si vëzhgues në takimet e Komitetit të Ekspertëve.

b) Drejtori i Përgjithshëm fton organizatat ndërqeveritare të specializuara në fushën e markave, prej të cilave të paktën një nga vendet anëtare të jetë palë në këtë Marrëveshje, që të marrin pjesë si vëzhgues në takimet e Komitetit të Ekspertëve.

c) Drejtori i Përgjithshëm mund dhe, nëse kërkohet nga Komiteti i Ekspertëve, duhet të ftojë përfaqësues të organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare të marrin pjesë në diskutime në interes të tyre.

3. Komiteti i Ekspertëve duhet:

i. të kryejë ndryshime dhe shtesa të Klasifikimit të Elementeve Figurative;

ii. të dërgojë rekomandime te vendet e Unionit të Posaçëm, me qëllim lehtësimin e përdorimit të Klasifikimit të Elementeve Figurative dhe nxitjen e zbatimit të unifikuar;

iii. të ndërmarrë të gjitha masat e tjera, të cilat, pa asnjë përfshirje financiare të buxhetit të Unionit të Posaçëm ose të Organizatës, kontribuojnë në lehtësimin e zbatimit të Klasifikimit të Elementeve Figurative në vendet në zhvillim;

iv. të gëzojë të drejtën të krijojë nënkomitete dhe grupe pune.

4. Komiteti i ekspertëve miraton rregulloren e tij të brendshme. Rregullorja parashikon mundësinë për pjesëmarrjen e organizatave ndërqeveritare të përmendura në paragrafin 2, germa "b", në takimet e nënkomiteteve dhe të grupeve të punës së Komitetit të Ekspertëve, të cilët mund të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në zhvillimin e Klasifikimit të Elementeve Figurative.

5. Propozimet për ndryshime ose shtesa të Klasifikimit të Elementeve Figurative mund të jepen nga Zyra Kompetente e çdo vendi të Unionit të Posaçëm, Byrosë Ndërkombëtare, çdo organizate ndërqeveritare të përfaqësuar në Komitetin e Ekspertëve, në përputhje me paragrafin 2, germa "b" dhe çdo vend apo organizatë të ftuar në mënyrë të veçantë nga Komiteti i Ekspertëve për depozitimin e këtyre propozimeve. Këto propozime përcillen te Byroja Ndërkombëtare, e cila ua dërgon ato anëtarëve të Komitetit të Ekspertëve dhe vëzhguesve, jo më vonë se 2 muaj para seancës së Komitetit të Ekspertëve, ku duhet të shqyrtohen këto propozime.

6.

a) Çdo vend anëtar i Komitetit të Ekspertëve gëzon të drejtën e një vote.

b) Vendimi i Komitetit të Ekspertëve kërkon një shumicë të thjeshtë të votave të vendeve të përfaqësuara dhe që gëzojnë të drejtë vote.

c) Çdo vendim që një e pesta e vendeve të përfaqësuara dhe me të drejtë vote e konsideron se sjell ndonjë ndryshim të strukturës bazë të Klasifikimit të Elementeve Figurative ose që përfshin shuma thelbësore të riklasifikimit, kërkon një shumicë prej tri të katërtave të votave të vendeve të përfaqësuara dhe që gëzojnë të drejtë vote.

d) Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

Neni 6
Njoftimi, hyrja në fuqi dhe botimi i ndryshimeve, shtesave dhe vendimeve të tjera

1. Çdo vendim i Komitetit të Ekspertëve, në lidhje me miratimin e ndryshimeve dhe të shtesave të Klasifikimit të Elementeve Figurative, si edhe rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve, u përcillet zyrave kompetente të vendeve të Unionit të Posaçëm nga Byroja Ndërkombëtare. Ndryshimet dhe shtesat hyjnë në fuqi gjashtë muaj nga data e dërgimit të njoftimit.

2. Byroja Ndërkombëtare i përfshin këto ndryshime dhe shtesa që kanë hyrë në fuqi në Klasifikimin e Elementeve Figurative. Shpalljet e këtyre ndryshimeve dhe shtesave publikohen në botimet periodike të përcaktuara nga Asambleja e përmendur në nenin 7.

Neni 7
Asambleja e Unionit të Posaçëm

1.

a) Unioni i Posaçëm ka një Asamble të përbërë nga vendet e Unionit të Posaçëm.

b) Qeveria e secilit vend të Unionit të Posaçëm përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë, këshilltarë dhe ekspertë të ndryshëm.

c) Çdo organizatë ndërqeveritare, e përmendur në nenin 5, paragrafi 2, germa "b", mund të përfaqësohet nga një vëzhgues në takimet e Asamblesë dhe, nëse Asambleja vendos, edhe në ato komitete dhe grupe pune të krijuara nga Asambleja.

d) Shpenzimet e secilit delegacion mbulohen nga qeveria që e ka caktuar atë.

2.

a) Në bazë të dispozitave të nenit 5, Asambleja, duhet:

i. të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit të Posaçëm dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

ii. të japë udhëzime për Byronë Ndërkombëtare në lidhje me përgatitjen për konferencat e rishikimit;

iii. të shqyrtojë dhe të miratojë raportet dhe veprimtaritë e Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe t'i japë atij të gjitha udhëzimet e nevojshme për çështjet që mbulohen nga Unioni i Posaçëm;

iv. të përcaktojë programin dhe të miratojë buxhetin dyvjeçar të Unionit të Posaçëm, si dhe të miratojë llogaritë e tij përfundimtare;

v. të miratojë rregulloret financiare të Unionit të Posaçëm;

vi. të vendosë për hartimin e teksteve zyrtare të Klasifikimit të Elementeve Figurative në gjuhë të ndryshme, përveç gjuhës angleze dhe frënge;

vii. të krijojë komitete dhe grupe pune, siç mund ta çmojë të përshtatshme për të përmbushur objektivat e Unionit të Posaçëm;

viii. të vendosë, në përputhje me paragrafin 1, germa "c", se cilat vende që nuk janë anëtare të Unionit të Posaçëm dhe cilat organizata joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare do të lejohen të jenë vëzhguese në takimet e tyre dhe në komitetet apo grupet e tjera të punës të themeluara prej tij;

ix. ndërmerr çdo masë tjetër të përshtatshme që synon të realizojë objektivat e Unionit të Posaçëm;

x. kryen funksione të tjera të përshtatshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në lidhje me çështjet në interes të Unioneve të tjera të administruara nga Organizata, Asambleja merr vendimin e saj pasi të jetë konsultuar me Komitetin Koordinues të Organizatës.

3.

a) Çdo vend anëtar i Asamblesë gëzon një votë.

b) Gjysma e vendeve anëtare të Asamblesë përbën një kuorum.

c) Në mungesë të kuorumit, Asambleja mund të marrë vendime, por, me përjashtim të vendimeve që lidhen me vetë procedurën e saj, të gjitha vendimet e tjera hyjnë në fuqi vetëm nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje. Byroja Ndërkombëtare ua përcjell këto vendime shteteve anëtare të Asamblesë, të cilat nuk kanë qenë të pranishme dhe i fton të hedhin me shkrim votën apo abstenimin e tyre, brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Nëse, pas skadimit të kësaj periudhe, numri i vendeve që kanë hedhur votën ose kanë abstenuar në këtë mënyrë arrin numrin e shteteve që mungonin për arritjen e kuorumit në seancë, këto vendime hyjnë në fuqi me kusht që në të njëjtën kohë të fitohet shumica e nevojshme.

d) Në bazë të dispozitave të nenit 11, paragrafi 2, vendimet e Asamblesë kërkojnë dy të tretat e votave të hedhura.

e) Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

f) Një delegat mund të përfaqësojë dhe të votojë vetëm në emër të një vendi.

4.

a) Asambleja mblidhet një herë çdo dy vite kalendarike në seancë të rregullt me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe, me përjashtim të kushteve të jashtëzakonshme, në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtin vend me Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës.

b) Asambleja mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me thirrjen e Drejtorit të Përgjithshëm, me kërkesën e një të katërtës së vendeve anëtare të Asamblesë.

c) Rendi i ditës i çdo seance përgatitet nga Drejtori i Përgjithshëm.

5. Asambleja miraton rregulloren e saj të brendshme.

Neni 8
Byroja Ndërkombëtare

1.

a) Detyrimet administrative në lidhje me Unionin e Posaçëm përmbushen nga Byroja Ndërkombëtare.

b) Në veçanti, Byroja Ndërkombëtare përgatit mbledhjet dhe takimet dhe siguron Sekretariatin për Asamblenë, Komitetin e Ekspertëve dhe komitete të tjera apo grupet e punës, siç mund të jenë krijuar nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve.

c) Drejtori i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i Unionit të Posaçëm dhe përfaqëson Unionin e Posaçëm.

2. Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar tjetër i stafit i emëruar prej tij merr pjesë pa të drejtë vote në të gjitha takimet e Asamblesë, Komitetit të Ekspertëve dhe komiteteve të tjera apo grupeve të punës të krijuara nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve. Drejtori i Përgjithshëm ose një anëtar tjetër i stafit të caktuar prej tij, është sekretar *ex officio*/i caktuar kryesisht i këtyre organeve.

3.

a) Byroja Ndërkombëtare përgatit konferencat e rishikimit në përputhje me direktivat e Asamblesë.

b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare në lidhje me përgatitjet për konferencat e rishikimit.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e zhvilluara në këto konferenca.

4. Byroja Ndërkombëtare kryen çdo detyrë tjetër që i është caktuar.

Neni 9
Financat

1.

a) Unioni i Posaçëm duhet të ketë një buxhet.

b) Buxheti i Unionit të Posaçëm përfshin të ardhurat dhe shpenzimet që i takojnë Unionit të Posaçëm, kontributin e tij në buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta për sindikatat e administruara nga organizatat dhe, sipas rastit, shumën e vënë në dispozicion të buxhetit të Konferencës së Organizatës.

c) Shpenzimet që nuk i atribuohen ekskluzivisht Unionit të Posaçëm, por as ndonjë apo më shumë sindikatave të tjera të administruara nga Organizata, konsiderohen si shpenzime të përbashkëta për sindikatat. Pjesa e këtyre shpenzimeve të përbashkëta që i takon Unionit të Posaçëm është në raport me interesin e Unionit të Posaçëm në to.

2. Buxheti i Unionit të Posaçëm krijohet duke pasur parasysh kërkesat e koordinimit me buxhetet e Sindikatave të tjera të administruara nga Organizata.

3. Buxheti i Unionit të Posaçëm financohet nga burimet e mëposhtme:

i. kontributet e vendeve të Unionit të Posaçëm;

ii. tarifat dhe detyrimet për shërbime të kryera nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm;

iii. shitjen e/ose honorarët nga botimet e Zyrës Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm;

iv. dhuratat, trashëgimia dhe subvencionet;

v. qiratë, interesat dhe të ardhura të tjera të ndryshme.

4.

a) Me qëllim përcaktimin e kontributit të tij sipas paragrafit 3, germa "i", çdo vend i Unionit të Posaçëm i përket së njëjtës klasë që i përket në Unionin e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe paguan kontributet e tij vjetore në bazë të njësive të përcaktuara për atë klasë në atë Union.

b) Kontributi vjetor i secilit vend të Unionit të Posaçëm është shuma në raport me shumën totale që duhet të paguhet në buxhetin e Unionit të Posaçëm nga të gjitha vendet, sipas numrit të njësive në totalin e njësive të të gjitha vendeve kontribuese.

c) Kontributet duhet të paguhen në fillim të muajit janar të çdo viti.

d) Vendi që nuk paguan kontributin e tij nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij të votës në asnjë organ të Unionit të Posaçëm, nëse shuma e detyrimit të tij është e barabartë ose më e madhe se shuma e kontributeve që i detyrohen atij për dy vitet e plota të mëparshme. Megjithatë, çdo organ i

Unionit të Posaçëm mund të lejojë që ky vend të vazhdojë të ushtrojë të drejtën e tij të votës në atë organ nëse, dhe për sa kohë që bindet se vonesa e pagesës ka ndodhur për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të pashmangshme.

e) Nëse buxheti nuk miratohet para fillimit të një periudhe të re financiare, ai duhet të jetë në të njëjtin nivel me buxhetin e vitit paraprak, siç parashikohet në rregulloret financiare.

5. Duhet të vendoset shuma e tarifave dhe e detyrimeve për shërbimet e kryera nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i raportojë Asamblesë këtë shumë.

6.

a) Unioni i Posaçëm ka një fond të kapitalit qarkullues, i cili përbëhet nga një pagesë e vetme e kryer nga çdo vend i Unionit të Posaçëm. Nëse ky fond bëhet i pamjaftueshëm, Asambleja vendos ta rrisë atë.

b) Shuma e pagesës fillestare të secilit vend në fondin në fjalë ose pjesëmarrja e tij në rritjen e këtij fondi është pjesë e kontributit të atij vendi për vitin kur është krijuar ky fond ose kur është marrë vendimi për rritjen e tij.

c) Pjesa dhe kushtet e pagesës përcaktohen nga Asambleja me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe pasi të ketë dëgjuar këshillat e Komitetit Koordinues të Organizatës.

7.

a) Në Marrëveshjen për selinë, të nënshkruar me vendin në territorin e të cilit Organizata ka selinë, duhet të parashikohet që sa herë që fondi i kapitalit qarkullues të jetë i pamjaftueshëm, ky vend duhet të paguajë pagesa paraprake. Shuma e këtyre pagesave paraprake dhe kushtet e pagesës u nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta, në çdo rast, midis këtij vendi dhe Organizatës.

b) Vendi i përmendur në nënparagrafin "a" dhe Organizata kanë të drejtë të përfundojnë detyrimin për dhënien e pagesave paraprake, nëpërmjet një njoftimi shkrim. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi tre vjet pas përfundimit të vitit kur është njoftuar.

8. Auditimi i llogarive kryhet nga një ose më shumë vende të Unionit të Posaçëm ose nga audituesë të jashtëm, siç parashikohet në rregulloret financiare. Ato përcaktohen nga Asambleja me miratimin e tyre.

Neni 10
Rishikimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mund të rishikohet herë pas here në një konferencë të veçantë të vendeve të Unionit të Posaçëm.

2. Asambleja vendos për thirrjen e çdo konference rishikuese.

3. Nenet 7, 8, 9 dhe 11 mund të ndryshohen nëpërmjet një konference rishikimi ose në përputhje me dispozitat e nenit 11.

Neni 11
Ndryshimet e dispozitave të caktuara të Marrëveshjes

